

V E N D I M
Nr.438, datë 17.6.1996

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.560, DATË 16.10.1995 “PËR MASAT PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7699, DATË 21.4.1993 “PËR KOMPENSIMIN NË VLERË TË ISH-PRONARËVE TË TOKËS BUJQËSORE”

Në zbatim të ligjit nr.7699, datë 21.4.1993 “Për kompensimin në vlerë të ish-pronarëve të tokës bujqësore”, mbështetur në nenet 7/1, 7/2 dhe 7/3 , me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë e të Ushqimit dhe të Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.560, datë 16.10.1995, pas pikës 5 shtohet pika 5/1 me këtë përmbajtje:

“Pretendentët ish-pronarë të kullotave, livadheve, tokave pyjore e pyjeve, në zbatim të neneve 7/1, 7/2 dhe 7/3 të ligjit nr.7699, datë 21.4.1993 , duhet të hapin dosje të veçantë, e cila, krahas dokumenteve të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “d” të pikës 5, të përmbajë edhe këto dokumente:

a) Aktet e pronësisë të lëshuara nga zyrat e hipotekës, të kadastrës ose Arkivi i Shtetit, me të cilat vërtetohet se kanë qenë pronarë deri momentin e daljes së ligjit nr.108, datë 29.8.1945.

b) Planvendosjen me kufizimet sipas dokumentacionit të pronësisë nga kadastra.

c) Vërtetimin e lëshuar nga drejtoritë e shërbimit pyjor ose kadastrat në rrethe, me të cilin përcaktohet gjendja kadastrale e sipërfaqes së pretenduar në datën 1.8.1991”.

2. Pas pikës 11 shtohet pika 11/1 me këtë përmbajtje:

“Një kopje e vendimit të komisionit të kthimit të pronës që trajton kthimin ose kompensimin e kullotave e livadheve, të tokës pyjore dhe pyjeve, paraqitet përkatësisht në drejtorinë e shërbimit pyjor ose në kadastrë, sipas administrimit të pronës që kthehet. Organet administruese i dorëzojnë me procesverbal pronarit sipërfaqet e përcaktuara për zbritjen e fondit të asaj toke nga kadastrat përkatëse”.

3. Pas pikës 11/1 shtohet pika 11/2 me këtë përmbajtje:

“Ish- pronarët ose trashëgimtarët e kullotave e livadheve, tokave pyjore e pyjeve bëjnë regjistrimin e pasurisë së paluajtshme sipas kërkesave të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme”.

4. Pas pikës 11/2 shtohet pika 11/3 me këtë përmbajtje:

“Sipas përcaktimit të nenit 7/2 kullotat, livadhet, tokat pyjore dhe pyjet që ndodhen tërërisht ose pjesërisht brenda vijave kufizuese mbrojtëse të zonave me përparësi turizmi (rezervatet, parqet kombëtare, monumentet e natyrës, zonat strikt të mbrojtura), mbeten në pronësi shtetërore dhe për to ish-pronarët ose trashëgimtarët do të kompensohen”.

5. Pika 14 të ndryshohet si vijon:

“Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit (nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve dhe Kullotave), Ministria e Financave, Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve, komisionet e kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve në rrethe, si dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit e degët e saj në rrethe”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi